



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 8698 / Prot. 30

Divjakë më 27/08 / 2025

RAPORT VENDIMMARRJE

I Komisionit të Bujqësisë dhe Pyjeve të Këshillit Bashkiak Divjakë

Komisioni i Bujqësisë dhe Pyjeve të Këshillit Bashkiak Divjakë, në mbledhjen e tij, shqyrtoi dhe analizoi Planin e Menaxhimit të Pyjeve të Bashkisë Divjakë për periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe bazës ligjore, komisioni vlerëson rëndësinë e këtij plani si një instrument thelbësor për administrimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore të bashkisë.

Baza Ligjore-Ligji nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore”;- Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 437, datë 20.07.2016, “Për miratimin e rregullores për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve”;- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Pyjeve;- Direktivave dhe standardeve të Bashkimit Evropian për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.

Rëndësia e Planit;Plani i Menaxhimit të Pyjeve është një dokument strategjik që synon:
- Të sigurojë ruajtjen, mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të pasurisë pyjore;- Të parandalojë shfrytëzimin e pakontrolluar dhe degradimin e pyjeve;- Të përmirësojë cilësinë e shërbimeve ekosistematike dhe të mbështesë biodiversitetin;- Të rrisë të ardhurat për komunitetin përmes shfrytëzimit racional të burimeve pyjore;- Të kontribuojë në përmbushjen e objektivave kombëtare për mjedisin dhe përafrimin me standardet e BE-së;- Të krijojë baza të qarta për planifikim afatgjatë dhe kontroll të përdorimit të pyjeve.

Përfundime dhe Rekomandime;Komisioni i Bujqësisë dhe Pyjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin teknik dhe ligjor, arrin në përfundimin se Plani i Menaxhimit të Pyjeve është një domosdoshmëri për administrimin e qëndrueshëm të pyjeve të Bashkisë Divjakë. Ky plan siguron një qasje afatgjatë, të strukturuar dhe të qëndrueshme për ruajtjen e ekosistemeve pyjore dhe zhvillimin ekonomik vendor. Në këtë kuadër, Komisioni i Bujqësisë dhe Pyjeve, pas degjësës publike që u organizua, sipas ligjit për kete plan, i propozon Këshillit Bashkiak Divjakë **miratimin në tërësi të Planit të Mbarështrimit të Pyjeve 2025-2035.**

KOMISIONI I BUJQËSISË,PYJEVE,MBROJTJES SË MJEDISIT

1.Shpëtim Sheshi (kryetar)

2.Ardjan Shurdhaqi (zv.kryetar)

3.Njazi Balla (sekretar)

4. Ajete Mebelli (anëtar)

5. Seit Kajo (anëtar)

6.Mishel Verdha (anëtar)

7.Lili Biti (anëtar)

